



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 25 nëntor 2024  
Nr. ref.: RK 2580/24

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI187/22**

Parashtrues

**Elmi Mena**

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 165/2022 të 6 korrikut 2022**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Bajram Ljatifi, gjyqtar  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Elmi Mena, me vendbanim në fshatin Bregu i Zi, Komuna e Lipjanit (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev. nr. 165/2022] të 6 korrikut 2022, të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 1952/2020] e 16 janarit 2022, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C. nr. 526/2018] e 12 shkurtit 2020, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-dega në Lipjan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e kishte pranuar më 6 shtator 2022.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkëlur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

7. Më 29 nëntor 2022, parashtruesi i kërkesës përmes postës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 5 dhjetor 2022, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
9. Më 9 dhjetor 2022, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

11. Më 10 korrik 2023, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga ajo që ta bashkëlidhte fletëkthesën që dëshmonte datën e pranimit të vendimit të kontestuar nga ana e parashtruesit të kërkesës.
12. Më 29 gusht 2023, Gjykata Themelore e njoftoi Gjykatën që lënda ende gjendet në Gjykatën Supreme të Kosovës.
13. Më 4 shtator 2022, Gjykata në bazë të informatave të pranuar nga Gjykata Themelore, kërkoi nga Gjykata Supreme që të bashkëlidhte fletëkthesën që dëshmonte datën e pranimit të vendimit të kontestuar nga ana e parashtruesit të kërkesës.
14. Më 8 shtator 2023, Gjykata Supreme përmes postës elektronike dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën që dëshmonte se parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar Aktgjykimin e kontestuar më 6 shtator 2022.
15. Më 17 janar 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe kërkoi plotësimin e kërkesës.
16. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
17. Më 5 nëntor 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

18. Kërkesa në fjalë ka të bëjë me disa paluajtshmëri, përkatësisht me ngastrat kadastrale nr. [P-71409087-00198-0], në vendin e quajtur "*Sello u davorishte*" në sipërfaqe prej 944m<sup>2</sup>, ngastrës kad. nr. [P-71409087-00244-0] në vendin e quajtur "*Shkark gornje pashnjak*" në sipërfaqe prej 5209 m<sup>2</sup>, ngastra kadastrale nr. [P-71409087-00245-0] në vendin e quajtur "*Shark Gornja livada*", në sipërfaqe prej 8115 m<sup>2</sup>, ngastra kadastrale nr. [P-71409087-00110-0], në vendin e quajtur "*Njive Ispod puta*" në sipërfaqe prej 26127 m<sup>2</sup>, ngastra kad.nr. [P-71409087-00111-0] në vendin e quajtur "*Njive Ispod Puta*" në sipërfaqe prej 320 m<sup>2</sup>, ngastra kad. nr. [P-71409087-00127-0] në vendin e quajtur "*Njive Ispod puta*" në sipërfaqe prej 1313 m<sup>2</sup>, ngastra kad. nr. P-71409087-00129-0 në vendin e quajtur "*Njive ispod shliva*" në sipërfaqe prej 23960m<sup>2</sup>, ngastra kad.nr. [P-71409087 -00149-0] në vendin e quajtur "*Sello Shark*" në sipërfaqe prej 6816m<sup>2</sup>, ngastrës kadastrale [P-71409087 -00150-0] në vendin e quajtur "*Shark*" në sipërfaqe prej 12038 m<sup>2</sup>, dhe ngastrës kadastrale nr. [P-71409087-00339-0] në vendin e quajtur "*Shark Zajednike*" në sipërfaqe prej 2731 m<sup>2</sup>, të gjitha këto ngastra kadastrale në ZK Bregu i Zi, të evidentuara në Komunën e Lipjanit. Paluajtshmëritë në fjalë ishin blerë nga Komuna e Lipjanit, nga disa pronarë privat (në vitet e 60-ta). Mjetet për blerjen e tyre i kishte siguruar "Fondi Ndërkombëtar për Refugjatë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara", me seli në Gjenevë të Zvicrës, me qëllim të strehimit dhe integritetit të refugjatëve të ardhur nga Shqipëria në vitet e 60-ta. Këto paluajtshmëri iu dhanë më pas në shfrytëzim me mirëbesim paraardhësit të parashtruesit të kërkesës, të ndjerit Ahmet Mena, në vitin 1969. Megjithatë, pronësia mbi këto paluajtshmëri që nga ajo kohë kishte mbetur e regjistruar në emër të Komunës së Lipjanit.
19. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës së bashku me vëllezërit Afrim Mena, Arsim Mena, Agim Mena, si dhe motra e tyre Florije Mena-Duga, parashtruan kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Lipjan, me të cilën kërkuan vërtetimin e pronësisë mbi paluajtshmëritë e lartcekura, me pretendimin se të njëjtat i kanë fituar me posedim të ligjshëm prej vitit 1969 nga Komuna e Lipjanit.

20. Më 12 dhjetor 2012, e paditura - Komuna e Lipjanit parashtroi përgjigje në padi në të cilën theksonte se pronat e kërkuara në kërkesëpadi nga parashtruesi i kërkesës figurojnë si pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal të Lipjanit, ZK Bregu i Zi, dhe se të njëjtit nuk posedojnë ndonjë dokument që dëshmon lejimin e shfrytëzimit të patundshmërive, paraardhësit të parashtruesit të kërkesës. Rrjedhimisht, e njëjta kërkonte nga Gjykata Themelore që kërkesëpadi të refuzohet si e pabazuar.
21. Më 29 janar 2014, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 98/2010]: (I) aprovoi padinë e parashtruesit të kërkesës, si dhe të Elmi Mena, Afrim Mena, Arsim Mena, Agim Mena si dhe Florije Mena-Duga, duke vërtetuar se të njëjtit e kanë fituar pronësinë me posedim me mirëbesim dhe të ligjshëm në paluajtshmëritë e kontestuara, që të gjitha këto ngastra kadastrale në ZK Bregu i Zi, dhe obligoi të paditurën Komunën e Lipjanit, që paditësve t'ua njoh të drejtën e pronësisë në këto paluajtshmëri dhe të duroj që paditësit në këto paluajtshmëri të regjistrohen si bashkëpronarë në librat publikë të paluajtshmërive, në të kundërtën ky aktgjykim paraqet titull juridik për regjistrimin e këtyre paluajtshmërive në bashkëpronësi të paditësve në librat publikë të paluajtshmërive. (II) Secila palë ndërgjyqëse i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore. Gjykata e shkallës së parë në Aktgjykimin e saj arsyetoi si në vijim:

*“Mbi bazën e këtyre provave të sipërpërmendura e të cilat u administruan në shqyrtim kryesor, e të cilave gjykata ua fali në tërësi besimin, nga se me asnjë kundërprovë nuk u vënë në dyshim, vërtetohet se paraardhësi i paditësve, i ndjeri Ahmet Mena me familje, në vitet 1967, për shkak të represionit nga shteti socialist i Shqipërisë i asaj kohe, si refugjat politik është ardhur në Kosovë, dhe për integritet sa më të lehtë në Kosovë, me mjetet që ka dhënë fondi ndërkombëtar për refugjat politik me seli në Gjenevë, nga komuna e Lipjanit është blerë toka në fshatin Breg i Zi nga pronarët, tokë kjo e cila është regjistruar në librat përkatëse të paluajtshmërisë në emër të Komunës së Lipjanit, dhe paraardhësit të paditësve e tani të ndjerit Ahmet Mena me familje, i është dhënë në shfrytëzim me kontratë paluajtshmëria, më përparësisht e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paluajtshmëri këtë të cilën sa ka qenë në jetë i ndjeri Ahmet Mena, e ka pasur në posedim të qetë dhe të pandërprerë që nga viti 1967, ndërsa pas vdekjes së tij pasardhësit e tij, e tani paditësit kanë vazhduar ta mbajnë në posedim deri në ditët e sotme duke e shfrytëzuar dhe punuar pa asnjë shqetësim nga askush.*

*Me dispozitën e nenit 20, par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 6), parashihet se e drejta e pronësisë fitohet sipas vet ligjit në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgimi.*

*Me dispozitën e nenit 28, par. 4 i po të njëjtit ligj, parashihet se mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send në parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh”.*

22. Në një datë të pasaktësuar, Komuna e Lipjanit parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
23. Më 4 dhjetor 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac. nr. 1130/2014] e pranoi ankesën e të paditurës Komunës së Lipjanit dhe prishi Aktgjykimin [C. nr. 98/2010] e 29 janarit 2014, duke e kthyer lëndën në rigjykim në Gjykatën e shkallës së parë. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj Gjykata e Apelit theksoi si në vijim:

*“Gjykata e shkallës së parë, në momentin e vendosjes nuk e ka vërtetuar në mënyrë të padryshimtë se a plotësohen tri kushtet e parapara me nenin 28 të LMTHJP-së, për*

*fitimin e të drejtës së pronësisë në paluajtshmërinë lëndore e cila evidentohet si pronë shoqërore e Komunës së paditur, që janë: posedimi, mirëbesimi dhe kalimi i kohës prej 20 vjet.*

*Padia e paditësve daton nga 22.4.2010, ndërsa gjykata e shkallës së parë ka vendosur me datën 29.1.2014, pa u plotësuar as koha prej 20 vjetësh, e cila llogaritet nga data 4.7.1996, kur ka hyrë në fuqi Ligji për Ndryshimet dhe Plotësimet e LMTHJP-së, e në vazhdim, e jo më parë, sepse i njëjti nuk ka fuqi prapavepruese”.*

24. Më 12 shkurt 2020, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 526/2018]: (I) aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe paditësve, Afrim Mena, Arsim Mena, Agim Mena dhe Florije Duga e vajzërisë Mena, dhe vërtetoi se të njëjti e kanë fituar pronësinë me posedim me mirëbesim dhe të ligjshëm të paluajtshmërive kontestuese, si dhe obligoi të paditurën Komunën e Lipjanit, që paditësve t’ua njoh të drejtën e pronësisë në këto paluajtshmëri dhe të duroj që paditësit në këto paluajtshmëri të regjistroheshin si bashkëpronarë në librat publikë të paluajtshmërive, në të kundërtën ky aktgjykim paraqet titull juridik për regjistrimin e këtyre paluajtshmërive në bashkëpronësi të paditësve në librat publikë të paluajtshmërive. (II) Secila palë ndërgjyqëse i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.
25. Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, kanë paraqitur ankesë e paditura Komuna e Lipjanit: (i) për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, (ii) konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Gjykatës që të aprovohet ankesa e saj në tërësi si e bazuar, dhe të prishet në tërësi aktgjykimi i atakuar, si dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje ose të ndryshohet aktgjykimi i shkallës së parë dhe të refuzohet kërkesëpadia.
26. Parashtruesi i kërkesës dorëzoi përgjigje në ankesë, me të cilën kanë kërkuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.
27. Më 26 janar 2022, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 1952/2020]: (I) aprovoi si të bazuar ankesën e të paditurës Komuna e Lipjanit, ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [C. nr. 526/2018] të 12 shkurtit 2020, dhe çështja lëndore u gjykua si në vijim: *Refuzohet si tërësisht e pabazuar kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës dhe paditësve Afrim Mena, Arsim Mena, Agim Mena dhe Florije Mena-Duga, me të cilën kanë kërkuar që: "të vërtetohet se paditësit e kanë fituar të drejtën e pronësisë me posedim me mirëbesim dhe të ligjshëm në paluajtshmërinë në përbërje prej ngastrës kadastrale [P-71409087-00198-0], në vendin e quajtur "Sello u dvorishte", në sipërfaqe prej 944 m<sup>2</sup>, ngastrës kadastrale nr. [P-71409087-00244-0], në vendin e quajtur "Shkark gomje pashnjak", në sipërfaqe prej 5209 m<sup>2</sup>, ngastra kadastrale nr. [P-71409087-00245-0], në vendin e quajtur "Shark gomja livada", në sipërfaqe prej 8115 m<sup>2</sup>, ngastra kadastrale nr. [P-71409087-00110-0], në vendin e quajtur "Njiva Ispod puta", në sipërfaqe prej 320 m<sup>2</sup>, ngastrën kadastrale nr. [P-7140987-00127-0], në vendin e quajtur "Njiva Ispot puta" në sipërfaqe prej 1313 m<sup>2</sup>, ngastra kadastrale nr. [P-71409087-00129-0], në vendin e quajtur "Njiva ispod shлива" në sipërfaqe prej 23960 m<sup>2</sup>, ngastrën kadastrale nr. [P-7140987-00149-0] në vendin e quajtur "Sello Shark" në sipërfaqe prej 6816 m<sup>2</sup>, ngastrën kadastrale nr. [P-71409087-00150-0] në vendin e quajtur "Shark" në sipërfaqe prej 12038 m<sup>2</sup>, dhe ngastrën kadastrale nr. [P-71409087-00339-0] në vendin e quajtur "Shark Zajednik" në sipërfaqe prej 2731 m<sup>2</sup>, të gjitha këto parcela në Z.K Bregu i Zi dhe obligohet e paditura Komuna e Lipjanit, që paditësve të ju njohë të drejtën e pronësisë në këto paluajtshmëri dhe të duroj që paditësit në këto paluajtshmëri të regjistroheshin si bashkëpronarë në librat publikë të paluajtshmërive, në të kundërtën ky aktgjykim paraqet titull juridik për regjistrimin e këtyre paluajtshmërive në bashkëpronësi të paditësve, në*

librat publike të paluajtshmërive"; (II) Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale. Në Aktgjykimin e saj Gjykata e Apelit arsyetoi si në vijim:

*“Në këtë drejtim, Gjykata e Apelit vlerëson se parashkrimi fitues në vete përmban katër elemente të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për të fituar të drejtën e pronësisë mbi një send të paluajtshëm: (1) mbajtësi i ligjshëm, (2) mirëbesimi, (3) kalimi i periudhës kohore të caktuar me ligj dhe (4) posedimi i sendit mbi të cilin dikush tjetër e ka të drejtën e pronësisë. [...] Si rrjedhojë, referuar provave të administruara nga gjykata e shkallës së parë rezulton se në rastin e paditësve nuk përmbushen në mënyrë kumulative elementet e cekura më lart, për të konstatuar se të njëjtit e kanë fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues mbi ngastrat kontestuese. Përveç të cekurave më lart, sipas Gjykatës së Apelit, mirëbesimi paraqet një gjendje përmes së cilës ai në vetvete supozohet se ekziston, deri sa nuk provohet e kundërta, mirëpo meqë kemi të bëjmë me pronë shoqërore, pronë kjo specifike që gëzon një mbrojtje dhe pozitë të veçantë në të drejtën aktuale pozitive, çështja e mirëbesimit në këtë rast duhet të provohet qartazi dhe dukshëm, pa lënë vend për mëdyshje. Në mungesë të një vërtetimi të tillë të ekzistimit të mirëbesimit në shfrytëzimin e pronës së paluajtshme nga paditësit, në të cilin shfrytëzim këta të fundit kanë bazuar kërkesën për vërtetim të së drejtës së tyre të pronësisë, Gjykata e Apelit konsideron se gjykata e shkallës së parë ka vendosur gabimisht kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, ndërsa ankesën e të paditurës e vlerëson si të qëndrueshme, në tërësi.*

*Në anën tjetër, edhe nëse paditësit do të provonin faktin se ngastrat kontestuese i kanë në posedim më shumë se 20 vite, kjo nuk do të provonte automatikisht faktin se të njëjtit e kanë fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues, ashtu siç e parasheh neni 28 parag.4 i Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (LMTHJP) që ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridik të pretenduar. Kjo për faktin se me nenin 29 të LMTHJP-së, parashihet se në pronë shoqërore nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë me parashkrim fitues. Edhe pse me ndryshimet e mëvonshme të LMThJP-së të vitit 1996, neni në fjalë rezulton të jetë i fshirë, gjykata vlerëson se bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr.1999/24 për Ligjin në Fuqi, respektivisht Rregulloren e UNMIK-ut nr.2000/59 për Ndryshimin e Rregullores nr.1999/24 për Ligjin në Fuqi në Kosovë, në rastin konkret zbatohet LMThJP, i cili ka qenë në fuqi me 22.03.1989, e jo edhe ndryshimet e mëvonshme të tij (edhe nëse eventualisht do të zbatoheshin ndryshimet e ligjit të cekur më lartë, sërish nuk do të plotësoheshin kushtet ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, pasi që nga viti 1996 e deri në datën e parashtrimit të padisë 22.04.2010, nuk do të kalonte afati 20 vjeçar).”*

28. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë për revizion kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, për: (i) shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore; dhe (ii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që revizioni të aprovohet si i bazuar dhe që të prishet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe të mbetet në fuqi aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.
29. Më 6 korrik 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 165/2022] refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, paraqitur kundër Aktgjykimit [Ac. nr. 851/2017] të 16 qershorit 2021, të Gjykatës së Apelit. Në arsyetimin e aktgjykimit të saj, si pika të refuzimit të revizionit të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme theksoi si në vijim:

*“Pretendimet e revizionit që paditësi është në posedim të papenguar të pronës së kërkuar dhe me këtë ka fituar pronësinë mbi bazën e parashkrimit fitues u refuzuan*

si të pabazuara. Lidhur me pretendimin e revizionit se paditësi është një kohë të gjatë në posedim të papenguar, Gjykata Supreme miraton qëndrimin e gjykatave më të ulëta dhe arsyetimin e dhënë në rastin konkret se çështja e posedimit nuk krijon raport pronësor e as të drejtë pronësie sepse në regjistrat kadastral figuron se prona është në pronësi të Komunës së Lipjanit. Në nenin 29 të LMTHPJ-së ka qenë e paraparë që "E drejta e pronësisë mbi sendet e paluajtshme, në pronësi shoqërore, nuk mund të fitohet mbi bazën e parashkrimit fitues." Me nenin 16 të Ligjit për ndryshimin e Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (Fl. zyrt. e Jug. Nr. 29/96) është shlyer kjo dispozitë ligjore, pra neni 29 i këtij Ligji dhe është lejuar fitimi i pronësisë me mbajtje nën kushtet e caktuara me ligj."

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, norma ligjore bëhet për të rregulluar raportet juridike në të ardhmen, dhe nuk është parashikuar se kjo normë ka ndikim prapaveprues."

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

30. Parashtruesi i kërkesës përmes vendimit të kontestuar pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
31. Fillimisht, parashtruesi i kërkesës thekson që Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kishin arsyetuar vendimmarrjen ndryshe në rrethana të ngjashme faktike dhe juridike, përkatësisht nuk kishin dhënë arsyetim (i) nëse ka pasur trajtim dhe vendimmarrje tjetër të Gjykatës Themelore në rrethanat e ngjashme faktike dhe juridike; dhe (ii) nëse përgjigja është pozitive, a ekzistojnë justifikime të arsyeshme për një devijim të tillë të praktikës gjyqësore.
32. Në thelb, parashtruesi i kërkesës ngre pretendime sa i përket të drejtës për vendim të arsyetuar gjyqësor, në kuadër të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Pra, parashtruesi thekson se bazuar në praktikën e Gjykatës, e njëjta kishte theksuar se mosdhënia e përgjigjeve të qarta dhe të plota përkritazi me pretendimet thelbësore dhe përcaktuese të ngritura nga parashtruesi i kërkesës, nuk është në përputhje me garancitë që ndërlihen me të drejtën për një vendim të arsyetuar, si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me Kushtetutë dhe KEDNJ. Rrjedhimisht, sipas parashtruesit të kërkesës "Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit dhe Supreme është nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale të përcaktuara me nenin 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta në proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."
33. Në vijim, lidhur me pretendimin për mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor, parashtruesi i kërkesës thekson se këto parime tashmë janë të zhvilluara në kuadër të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI49/20, me parashtruese *Shehide Muhadri*, i cili rast, sipas parashtruesit është "rast ky identik me Familjen Mena të ardhur refugjat nga Shqipëria."
34. Në vijim, parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes vendimit të kontestuar i janë shkelur të drejtat e përcaktuara nga neni 24 i Kushtetutës, ngase "[...] nga e njëjta (identike) bazë juridike - si refugjatë të Republikës së Shqipërisë, në të njëjtën kohë iu është dhënë në shfrytëzim paluajtshmëria (tokë) dhe nga Gjykata e shkallës së parë dhe shkallës së dytë, iu është njohur e drejta e pronësisë në raste të ngjashme nga e njëjta bazë."

## Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

### Kushtetuta e Republikës së Kosovës

#### Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

#### Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

### Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

#### Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë”.

## Dispozitat relevante ligjore

**LIGJI MBI MARRËDHËNIET THEMELORE JURIDIKE PRONËSORE (në zbatim prej 8 shkurtit 1980 deri më 26 qershor 1996)**



[...]

## *“2. Fitimi i së drejtës së pronësisë*

### *Neni 20*

*E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim.*

*E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj.*

### *Neni 28*

*Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të luajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fituese me kalimin e kohës prej tre vjetësh.*

*Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej dhjetë vjetësh.*

*Mbajtësi me mirëbesim i sendit të luajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej dhjetë vjetësh.*

*Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh.*

*Trashëgimtari bëhet mbajtës me mirëbesim nga momenti i hapjes së trashëgimisë edhe në rastin kur trashëgimlënësi ka qenë mbajtës me keqbesim, e trashëgimtari këtë nuk e ka ditur as që ka mundur ta dinte kurse koha për parashkrimin fitues fillon të ecë nga momenti i hapjes së trashëgimisë.*

### *Neni 29*

*Mbi sendin në pronësinë shoqërore e drejta e pronësisë nuk mund të fitohet me parashkrimin fitues. (Dispozitë e fshirë me plotësim–ndryshimin e ligjit).*

### *Neni 33*

*Në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj”.*

## **Pranueshmëria e kërkesës**

35. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të parapara më tej me Rregullore të punës.
36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

37. Gjykata gjithashtu i referohet edhe kritereve të pranueshmërisë, siç përcaktohen në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47  
(Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48  
(Saktësimi i kërkesës)

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

Neni 49  
(Afatet)

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.*

38. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 165/2022] të 6 korrikut 2022, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

39. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 34 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 34 (2) përcakton që:

*“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj.”*

40. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me

ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si “*pretendime qartazi të pabazuara*”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”; dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*” (shih, rastet e GjEDNJ-së, [Kemmachev kundër Francës, Kërkesa nr. 17621/91](#), kategoria (i), [Mentzen kundër Letonia, Kërkesa nr. 71074/01](#), kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës, Kërkesa nr. 4241/03](#), kategoria (iii)).

41. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
42. Gjykata vëren se esenca e këtij rasti ndërlidhet me padinë që parashtruesi i kërkesës e kishe paraqitur kundër Komunës së Lipjanit për vërtetimin e pronësisë për disa prona, të cilat pretendonin se ju takonin si rezultat i shfrytëzimit me mirëbesim për më shumë se 20 vite përmes parashkrimit fitues, prona këto të cilat u janë dhënë në shfrytëzim refugjatëve nga Shqipëria në vitin 1969. Fillimisht Gjykata Themelore aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës duke aprovuar kërkesëpadinë e tij, përmes së cilës vërtetohet se të njëjtit e kanë fituar pronësinë me posedim me mirëbesim dhe të ligjshëm në paluajtshmëritë e kontestuar. Pas ankesës së Komunës së Lipjanit, Gjykata e Apelit e pranoi si të bazuar ankesën e saj, duke e prishur aktgjykimin e Gjykatës Themelore si dhe duke e kthyer çështjen në rigjykim në të njëjtën gjykatë. Në vijim, në procedurën e rigjykimit, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 526/2018] të 12 shkurtit 2020, përsëri e aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës duke vërtetuar se të njëjtit kanë fituar pronësinë me posedim me mirëbesim dhe të ligjshëm në paluajtshmëritë kontestuese. Pas ankesës së Komunës së Lipjanit, Gjykata e Apelit aprovoi si të bazuar ankesën e saj, ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [C. nr. 526/2018] të 12 shkurtit 2020, dhe çështja lëndore u gjykua si në vijim: “*Refuzohet si tërësisht e pabazuar kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës*”. Pas kërkesës për revizion të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata Supreme e refuzoi si të pabazuar këtë kërkesë të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.
43. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar shkel të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregull) të KEDNJ-së.
44. Duke u nisur nga natyra dhe problematikat që i ngre ky rast, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës duhet të vlerësohen në kuadër të së drejtës për (i) një vendim të arsyetuar, siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si dhe (ii) pretendimet për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës.
45. Gjykata në vijim do t'i trajtojë ndaras këto dy pretendime, duke filluar me pretendimin për sa i përket vendimit të arsyetuar gjyqësor.

### ***Parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar***

46. Garancitë e mishëruara në nenin 6, paragrafin 1 të KEDNj-së, përfshijnë edhe detyrimin e gjykatave që të paraqesin arsyetim të mjaftueshëm për vendimet e tyre. (shih, rastin e GjEDNj-së, [H. kundër Belgjikës](#), nr. 8950/80, Aktgjykim i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53). Vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë.
47. Përkundër faktit që gjykatat kanë një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe vendosjes për pranueshmërinë e dëshmimeve, ato janë të detyruara të justifikojnë veprimet e tyre duke arsyetuar të gjitha vendimet e tyre (shih rastet e GjEDNj-së: [Suominen kundër Finlandës](#), nr. 37801/97, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 36; si dhe rastin [Carmel Saliba kundër Maltës](#), nr. 24221/13, Aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73).
48. Gjykata më e ulët ose autoriteti shtetëror, nga ana tjetër, duhet të japin arsye dhe arsyetime të tilla të cilat do t'u mundësojnë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës (shih rastin e GjEDNj-së [Hirvisaari kundër Finlandës](#), nr. [49684/99](#), i 25 dhjetorit 2001, paragrafi 30).
49. Pra, praktika gjyqësore e GjEDNj-së thekson se funksioni thelbësor i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për t'u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga një organ i apelit. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë (shih *mutatis mutandis*, rastin e GjEDNj-së [Hirvisaari kundër Finlandës](#), cituar më lart, paragrafi 30, [Tatishvili kundër Ruisisë](#), nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58 dhe [Suominen kundër Finlandës](#), cituar më lart, paragrafi 37).
50. Neni 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument (shih rastet e GjEDNj-së, [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 29 janarit 1999, paragrafi 26; [Perez kundër Francës](#), nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81).
51. Nga natyra e vendimit që merr Gjykata varet nëse gjykata është e detyruar ta arsyetojë atë, dhe kjo mund të vendoset vetëm në dritën e rrethanave të rastit në fjalë: është e nevojshme të merren parasysh, ndër të tjera, llojet e ndryshme të parashtresave që një palë mund t'i paraqesë gjykatës, si dhe dallimet që ekzistojnë midis sistemeve juridike të vendeve në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, pozicionet juridike dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjykimeve (shih rastet e GjEDNj [Ruiz Toria kundër Spanjës](#), nr. 18390/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), nr. 18064/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27).
52. Megjithatë, nëse parashtresa e një pale është vendimtare për rezultatin e procedurës, ajo kërkon që t'i përgjigjet në mënyrë specifike dhe pa vonesë (shih rastet e GjEDNj-së, [Ruiz Toria kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 30; Aktgjykimi [Hiro Balani kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 28).
53. Prandaj, sipas praktikës së GjEDNj-së, gjykatat nacionale janë të obliguara që:
- (a) të shqyrtojnë argumentet kryesore të palëve (shih rastet [Buzescu kundër Rumanisë](#), nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 gushtit 2005, paragrafi 67; [Donadze kundër Gjeorgisë](#), nr. 74644/01, Aktgjykim i 7 qershorit 2006, paragrafi 35);

- (b) të shqyrtohen me shumë rigorozitet dhe kujdes të veçantë kërkesat në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, KEDNj dhe Protokollet e saj (shih rastet e GjEDNj-së: [Fabris kundër Francës](#), cituar më lart, paragrafi 72; [Wagner dhe JMWL kundër Luksemburgut](#), nr. 76240/01, Aktgjykim i 28 qershorit 2007, paragrafi 96).
54. Në mënyrë të ngjashme, në një rast ku bëhet fjalë për një kërkesë që të lejohet parashtrimi i ankesës, që është një parakusht për procedurën te një gjykatë më e lartë, si dhe për një vendim të mundshëm, neni 6, paragrafi 1, nuk mund të interpretohet në atë kuptim që të urdhëron një arsyetim të detajuar të vendimit për refuzimin e kërkesës për parashtrimin e ankesës (shih rastet e GjEDNj-së, [Kukkonen kundër Finlandës](#) (nr. 2), nr. 47628/06, Aktgjykim i 13 prillit 2009,) paragrafi 24; [Bufferne kundër Francës](#), nr. 54367/00, Vendimi i 26 shkurtit 2002),
55. Përveç kësaj, kur refuzon një ankesë, Gjykata e Apelit, në parim, thjesht mund të pranojë arsyetimin e vendimit të dhënë nga gjykata më e ulët (shih rastin e GjEDNj-së, [García Ruiz kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 26; shih, në kundërshtim me këtë, [Tatishvili kundër Ruisë](#), nr. 1509/02, Aktgjykim i 9 korrikut 2007,) paragrafi 62). Megjithatë, koncepti i procedurës së drejtë nënkupton që gjykata vendase që ka dhënë një shpjegim të ngushtë për vendimet e saj, qoftë duke përsëritur arsyetimet e dhëna më parë nga një gjykatë më e ulët ose në ndonjë mënyrë tjetër, në fakt merrej me çështje të rëndësishme brenda juridiksionit të saj, që do të thotë se nuk i pranoi thjesht dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët (shih rastin [Helle kundër Finlandës](#), nr. (157/1996/776/977), Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60). Kjo kërkesë është aq më e rëndësishme nëse pala në kontest nuk ka pasur mundësi t'i paraqesë argumentet e saj gojarisht në procedurën para gjykatës vendase.
56. Megjithatë, gjykatat e apelit (në shkallën e dytë) të cilat kanë juridiksion për të hedhur poshtë ankesat e pabazuara dhe për të zgjidhur çështjet faktike dhe juridike në procedurën kontestimore, janë të obliguara të arsyetojnë se përse refuzuan të vendosin për ankesën (shih, rastin e GjEDNj-së, [Hansen kundër Norvegjisë](#), nr. 15319/09, Aktgjykim i 2 janarit 2015, paragrafët 77–83).
57. Në fund, Gjykata gjithashtu i referohet praktikës së saj gjyqësore ku ajo konstaton se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritave dhe reflektimeve kur të merren parasysh provat e propozuara nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk përmban fakte të vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre (Gjykata Kushtetuese, rastet: nr. [KI72/12](#), [Veton Berisha dhe Ilfete Haziri](#), Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; dhe nr. [KI135/14](#), [IKK Classic](#), Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58).

***Zbatimi i parimeve të përgjithshme lidhur me “vendimin e arsyetuar” në rrethanat e rastit konkret***

58. Gjykata rithekson se nuk është detyra e saj që t'i zëvendësojë gjykatat e rregullta, që janë në pozitë më të mirë për t'i vlerësuar provat në dispozicionin e tyre, t'i konstatojnë faktet dhe interpretojnë të drejtën vendore (shih rastin e GjEDNj-së, [Khamidov kundër Ruisë](#), nr. 72118/01, Aktgjykim i 15 nëntorit 2007, paragrafi 170). Gjykata thekson se kur bëhet fjalë për konstatimin e fakteve dhe interpretimin e ligjit, është e “ndjeshme” për natyrën subsidiare të rolit të saj dhe se duhet të jetë e kujdesshme në marrjen e rolit të gjykatës së faktit, veçse kur një gjë e tillë është bërë e pashmangshme nga rrethanat e rastit (shih rastin e GjEDNj-së, [Bărbulescu kundër Rumanisë](#), nr. 61496/08, Aktgjykim i 2017, paragrafi 129).

59. Gjykata thekson se në praktikën e saj gjyqësore në shumë raste ka konstatuar se çështjet e faktit dhe çështjet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit janë brenda fushëveprimit të gjykatave të rregullta dhe të autoriteteve të tjera publike, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe si të tilla janë çështje të ligjshmërisë, përveç dhe përderisa, çështje të tilla rezultojnë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ose krijojnë një situatë në kundërshtim me Kushtetutën (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës: [KI33/16](#), parashtruese *Minire Zeka*, Aktgjykim i 4 gushtit 2018, paragrafi 91). Pavarësisht nga hapësira e vlerësimit të gjykatave të rregullta, vendimi përfundimtar lidhur me respektim të kriterëve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së ngelet tek Gjykata Kushtetuese (shih dispozitat e neneve 4, paragrafi 6 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe 112, paragrafi 1 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës; dhe po ashtu, shih, *mutatis mutandis*, rastin e GjEDNj-së, [Konstantin Markin kundër Ruisë](#), nr. 30078/06, Aktgjykim i 22 marsit 2012, paragrafi 126).
60. Në këtë kontest, Gjykata vëren se në rrethanat e rastit konkret, çështja esenciale ndërlidhet me çështjen e (i) vlerësimit të kushteve për përfitimin e pronës në bazë të parashkrimit fitues dhe arsyetimit respektiv të dhënë nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme; si dhe (ii) faktit se premiset e vendimit të arsyetuar gjyqësor të dhëna në rastet e Gjykatës KI49/20, me parashtruese *Shehide Muhadri* dhe KI145/18, janë raste identike me rastin e parashtruesit të kërkesës dhe se të vendosurit ndryshe paraqet devijim nga praktika gjyqësore.
61. Në ndërlidhje me çështjet e lartcekura, Gjykata në vazhdim do t'iu referohet pjesëve relevante të aktgjykimeve të gjykatave të rregullta, që adresojnë pretendimet e parashtruesit të kërkesës. Fillimisht, Gjykata i referohet Aktgjykimit [Ac. nr. 1952/2020] të 26 janarit 2022, të Gjykatës së Apelit, përmes të cilit ishte aprovuar ankesa e të paditurës-Komuna e Lipjanit, ku arsyetohej çështja e posedimit të pronave dhe mundësia e fitimit përmes parashkrimit fitues si në vijim:

*“Gjithashtu nuk ishte kontestues fakti se me kontratën për dhënien e tokës me qira, e nënshkruar nga kryetari i Komunës së Lipjanit, Shyqeri Haziri dhe paraardhësit të paditësve Ahmet Mena, i është dhënë të njëjtëve në shfrytëzim me qira toka në pronësi shoqërore dhe atë ngastrat nr: 110, 111, 127, 129, 149, 150, 198, 244, 245, 339, në kohëzgjatje prej 10 vitesh (nga viti 1969-1978).*

[...]

*Nga të gjitha këto prova të administruara, rezultoi se ngastrat kadastrale pronësinë e të cilave paditësit e kërkojnë me kërkesëpadi, në vazhdimësi kanë qenë dhe janë të evidentuara si pronësi në emër të paditurës Komuna e Lipjanit (edhe para vitit 1969, kohë kur përmes kontratës paraardhësit të paditësve i janë dhënë në shfrytëzim për periudhën 10 vjeçare nga këtu e paditura Komuna e Lipjanit).*

[...]

*Në këtë drejtim, Gjykata e Apelit vlerëson se parashkrimi fitues në vete përmban katër elemente të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për të fituar të drejtën e pronësisë mbi një send të paluajtshëm: (1) mbajtësi i ligjshëm, (2) mirëbesimi, (3) kalimi i periudhës kohore të caktuar me ligj dhe (4) posedimi i sendit mbi të cilin dikush tjetër e ka të drejtën e pronësisë. [...] Si rrjedhojë, referuar provave të administruara nga gjykata e shkallës së parë rezultoi se në rastin e paditësve nuk përmbushen në mënyrë kumulative elementet e cekura më lartë, për të konstatuar se të njëjtit e kanë fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues mbi ngastrat kontestuese. Përveç të cekurave më lartë, sipas Gjykatës së Apelit, mirëbesimi paraqet një gjendje përmes së cilës ai në vetvete supozohet se ekziston, deri sa nuk provohet e kundërta, mirëpo meqë kemi të bëjmë me pronë shoqërore, pronë kjo specifike që*

gëzon një mbrojtje dhe pozitë të veçantë në të drejtën aktuale pozitive, çështja e mirëbesimit në këtë rast duhet të provohet qartazi dhe dukshëm, pa lënë vend për mëdyshje. Në mungesë të një vërtetimi të tillë të ekzistimit të mirëbesimit në shfrytëzimin e pronës së paluajtshme nga paditësit, në të cilin shfrytëzim këta të fundit kanë bazuar kërkesën për vërtetim të së drejtës së tyre të pronësisë, Gjykata e Apelit konsideron se gjykata e shkallës së parë ka vendosur gabimisht kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, ndërsa ankesën e të paditurës e vlerëson si të qëndrueshme, në tërësi.

*Në anën tjetër, edhe nëse paditësit do të provonin faktin se ngastrat kontestuese i kanë në posedim më shumë se 20 vite, kjo nuk do të provonte automatikisht faktin se të njëjtit e kanë fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues, ashtu siç e parasheh neni 28 parag.4 i Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (LMTHJP) që ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridik të pretenduar. Kjo për faktin se me nenin 29 të LMTHJP-së, parashihet se në pronë shoqërore nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë me parashkrim fitues. Edhe pse me ndryshimet e mëvonshme të LMTHJP-së të vitit 1996, neni në fjalë rezultoi të jetë i fshirë, gjykata vlerëson se bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr.1999/24 për Ligjin në Fuqi, respektivisht Rregulloren e UNMIK-ut nr.2000/59 për Ndryshimin e Rregullores nr.1999/24 për Ligjin në Fuqi në Kosovë, në rastin konkret zbatohet LMTHJP, i cili ka qenë në fuqi me 22.03.1989, e jo edhe ndryshimet e mëvonshme të tij (edhe nëse eventualisht do të zbatoheshin ndryshimet e ligjit të cekur më lartë, sërish nuk do të plotësoheshin kushtet ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, pasi që nga viti 1996 e deri në datën e parashtrimit të padisë 22.04.2010, nuk do të kalonte afati 20 vjeçar)."*

62. Po ashtu, Gjykata vëren se edhe Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 165/2022] të 6 korrikut 2022, kishte dhënë arsyetimin e saj lidhur me çështjen e parashkrimit fitues, ku ndër të tjera, arsyetoi:

*"Pretendimet e revizionit që paditësi është në posedim të papenguar të pronës së kërkuar dhe me këtë ka fituar pronësinë mbi bazën e parashkrimit fitues u refuzuan si të pabazuara. Lidhur me pretendimin e revizionit se paditësi është një kohë të gjatë në posedim të pa penguar, Gjykata Supreme miraton qëndrimin e gjykatave më të ulëta dhe arsyetimin e dhënë në rastin konkret se çështja e posedimit nuk krijon raport pronësor e as të drejtë pronësie sepse në regjistrat kadastral figuron se prona është në pronësi të Komunës së Lipjanit. Në nenin 29 të LMTHJP-së ka qenë e paraparë që "E drejta e pronësisë mbi sendet e paluajtshme, në pronësi shoqërore, nuk mund të fitohet mbi bazën e parashkrimit fitues." Me nenin 16 të Ligjit për ndryshimin e Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (Fl. zyrt. e Jug. Nr.29/96) është shlyer kjo dispozitë ligjore, pra neni 29 i këtij Ligji dhe është lejuar fitimi i pronësisë me mbajtje nën kushtet e caktuara me ligj."*

*Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, norma ligjore bëhet për të rregulluar raportet juridike në të ardhmen, dhe nuk është parashikuar se kjo normë ka ndikim prapaveprues.*

63. Gjykata rikujton se Gjykata Supreme, duke vlerësuar pretendimet e ngritura në revizion nga parashtruesi i kërkesës dhe gjetjet e Gjykatës së Apelit, arriti në konkluzionin se gjykatat e rregullta, pasi administruan të gjitha provat relevante, të drejtën materiale të zbatuar në rrethanat e rastit konkret, erdhën në përfundim që pavarësisht që parashtruesi i kërkesës i shfrytëzoi patundshmëritë kontestuese nga viti 1969 përmes kontratës për dhënie të tokës me qira, përderisa ishte e regjistruar si pasuri shoqërore, deri në ndryshimin e LMTHJP-së në vitin 1996, e drejta e pronësisë e patundshmërive të

kontestuara nuk ka mundur të fitohet përmes parashkrimit fitues. Pra, kjo e drejtë nuk ka mundur të fitohet as pas vitit 1996 sepse nga viti 1996 e deri në parashtrimin e padisë në vitin 2010 nuk kishte kaluar koha prej 20 vitesh e paraparë për parashkrim fitues në patundshmëri sipas nenit 28, paragrafi 4 të LMTHJP-së. Arsyeja e dytë përcaktuese të cilën e shtjelluan gjykatat e rregullta konsiston me çështjen se a ka pasur mirëbesim i cili u vlerësua në bazë të nenit 28, paragrafi 2 të Ligjit të lartpërmendur, ku kërkohet plotësimi kumulativ i dy kushteve ligjore për fitimin e pronësisë në patundshmëri: që mbajtësi të jetë me mirëbesim dhe posedimi të jetë i ligjshëm, ndërsa sipas paragrafit 4 të këtij neni kërkohet që mbajtësi të jetë me mirëbesim, që do të thotë se në dy paragrafët kërkohet që gjithësesi mbajtësi të jetë me mirëbesim, që në rastin konkret me vet faktin se paditësi e ka ditur se prona është e regjistruar si shoqërore në pronësi të paditurës, rezulton se mbajtja e pronës nga paditësit nuk mund të konsiderohet se është me mirëbesim.

64. Nga sa më sipër, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë adresuar dhe u janë përgjigjur të gjitha pretendimeve relevante të parashtruesit të kërkesës të ngritura përmes padisë dhe kërkesës për revizion, në lidhje me çështjen e fitimit të pronësisë përmes posedimit për periudhën mbi 20 vjeçare, përmes parashkrimit fitues, me ç' rast Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta kanë pasur prova të mjaftueshme dhe bindëse që mbështesin konkluzionin e tyre mbështetur në zbatimin e duhur të së drejtës materiale, përkitazi me vendimmarrjen në çështjen e parashtruesit të kërkesës.
65. Gjykata gjithashtu sjell në vëmendje që rrethanat e rastit konkret dallojnë nga rrethanat e rastit KI49/20, Aktgjykim ky në të cilin kontestohet vendimi i Gjykatës së Apelit, me ç' rast ishte vendosur se kishte shkelje kushtetuese të së drejtës për vendim të arsyetuar gjyqësor. Në këtë rast, Gjykata kishte ardhur në përfundim që Gjykata e Apelit nuk iu përgjigj pretendimit ankimor të parashtruesit të kërkesës që Gjykata Themelore kishte devijuar nga praktika e mëparshme lidhur me vendosjen për rrethana të njëjta faktike dhe juridike, në rastet e ngjashme.
66. Në rastin konkret, Gjykata sqaron që përveç dhënies së arsytimit përkatës nga Gjykata Supreme ndaj pretendimeve respektive, rasti i parashtruesit të kërkesës gjithashtu kishte kaluar nëpër të gjitha instancat e gjyqësorit të rregullt, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme. Në këtë kontekst, Gjykata vëren gjithashtu se Gjykata Supreme kishte trajtuar pretendimin e lartcekur të parashtruesit të kërkesës sipas të cilit në raste të ngjashme, kolegjet e Gjykatës së Apelit kanë vendosur ndryshe, mirëpo e njëjta gjykatë kishte sqaruar që secili aktgjykim i shkallës së dytë, mund t'i nënshtrohet procedurës sipas revizionit, me ç' rast përmes vendimit të Gjykatës Supreme mund të sanohet vendimmarrja e ndryshme e gjykatës së shkallës së dytë për situata të njëjta.
67. Me një konstatim të tillë të Gjykatës Supreme pajtohet dhe kjo Gjykatë, pasi vlerëson se është brenda fushëveprimit të saj që vendimin e marrë ta arsyetojë me dispozitat materiale në fuqi, si dhe të japë vlerësimin lidhur me mbështetjen e vendimit të Gjykatës së Apelit, pasi ka dhënë arsyetim të bazuar në prova bindëse të bazuar në zbatim të së drejtës materiale, për sa i përket pretendimit të parashtruesit në lidhje me fitimin e pronësisë përmes posedimit për periudhë 20 vjeçare, përmes parashkrimit fitues.
68. Gjykata saktëson se përfundimet e gjykatave të rregullta lidhur me mundësinë e fitimit të pronësisë mbi pronën publike përmes parashkrimit fitues, vlejnë vetëm në kuadër të rrethanave specifike të rastit konkret dhe nuk krijojnë një rregull të përgjithshëm për situata të tjera të ngjashme.
69. Gjykata, dëshiron të rikujtojë gjithashtu se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNj-së, i obligojnë gjykatat që të arsyetojnë vendimet e tyre, megjithatë, kjo nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që nga ato të kërkohet përgjigje e hollësishme për secilin



pretendim (shih rastet e GjEDNj-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, cituar më lart; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 26).

70. Për sa më sipër, në vlerësimin e pretendimeve që ndërlidhen me shkelje të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, Gjykata e konsideron të rëndësishme të ritheksojë qëndrimin e përgjithshëm se “*drejtësia*” e kërkuar nga nenet e lartpërmendura nuk është drejtësi “*substanciale*”, por drejtësi “*procedurale*”. Në rrafshin praktik, koncepti i “*drejtësisë procedurale*” nënkupton: (i) mundësinë e procedurave kontradiktore/parimi i kontradiktoritetit procedural; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmive të paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të degjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur (shih, ndër të tjera, rastin e GjEDNj-së: *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, nr. 10590/83, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI128/19, parashtrues *Artan Mala*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 shkurtit 2021, paragrafi 58; dhe KI22/19, parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).
71. Në këtë kontekst, Gjykata konsideron se në rastin e parashtruesit të kërkesës janë respektuar të gjitha kriteret e lartcekura nga ana e gjykatave të rregullta. Parashtruesi i kërkesës edhe më tej mund të mos jetë i kënaqur me rezultatin e gjykimit të çështjes, megjithatë, kjo pakënaqësi vetvetiu nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GjEDNj-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
72. Andaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, për shkelje të së drejtës për vendim të arsyetuar, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së, si të tilla i takojnë kategorisë së pretendimeve qartazi të pabazuara në baza kushtetuese në “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*” ashtu siç përcaktohet me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

### **Pretendimi për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës**

73. Gjykata në vijim rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon gjithashtu shkelje të nenit 24 të Kushtetutës dhe se këtë shkelje të pretenduar e ndërlidh me çështjen e dallimit në trajtim, ngase sipas parashtruesit të kërkesës “[...] nga e njëjta (identike) bazë juridike - si refugjatë të Republikës së Shqipërisë, në të njëjtën kohë iu është dhënë në shfrytëzim paluajtshmëria (tokë) dhe nga Gjykata e shkallës së parë dhe shkallës së dytë, iu është njohur e drejta e pronësisë në raste të ngjashme nga e njëjta bazë.”
74. Parashtruesi i kërkesës në mbështetje të këtij pretendimi kishte sjellë vendime të gjykatave të shkallës së parë dhe shkallës së dytë në të cilat këto gjykata kishin aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, si në vijim: (i) Aktgjykimin [C. nr. 164/2002] e 25 shkurtit 2003, të Gjykatës Komunale në Lipjan; (ii) Aktgjykimin [Ac. nr. 248/2003] e 27 majit 2004, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë; (iii) Aktgjykimin [C. nr. 63/2019] e 6 marsit 2020, të Gjykatës Themelore në Gjiilan; (iv) Aktgjykimin [C.nr. 814/2013] e 6 tetorit 2017, të Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

75. Në thelb, nga kërkesa rezulton se parashtruesi i kërkesës konsideron se i është shkelur e drejta për ndalimin e diskriminimit si rezultat i pabarazisë së palëve para ligjit, nga neni 24 i Kushtetutës në lidhje me të drejtën për një gjykim të drejtë. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se diskriminimi ekziston nëse rezulton me një trajtim të ndryshëm të individëve në situatat e ngjashme dhe nëse ky trajtim nuk ka justifikim objektiv ose të arsyeshëm. Për të qenë i justifikuar, trajtimi duhet të ndjek një qëllim legjitim, dhe duhet të ekzistojë një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit i cili duhet të realizohet (shih Aktgjykimin e GjEDNj-së, [Marckx kundër Belgjikës](#), kërkesa nr. 6833/74, të 13 qershorit 1976, paragrafi 33). Për këtë arsye është e nevojshme që në çdo rast konkret të përcaktohet nëse parashtruesi është trajtuar ndryshe nga të tjerët në situatat e njëjta apo të ngjashme.

76. Gjykata vëren se lidhur me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, tashmë e kishte trajtuar Gjykata Supreme në vendimin e kontestuar, ku fillimisht kishte theksuar kompetencën e kësaj Gjykate për konsolidimin e praktikës gjyqësore, duke arsyetuar si në vijim:

*“Lidhur me pretendimet e revizionit se në raste të ngjashme, kolegjet e Gjykatës së Apelit kanë vendosur ndryshe, Gjykata Supreme e pati në konsideratë dhe shqyrtoi rastet e ndryshme mbi të cilat pala e paditur në revizion potencon faktin se në raste tjera të ngjashme gjykata e shkallës së dytë në kolegje të ndryshme ka vendosur ndryshe, mirëpo secili aktgjykim i gjykatës së shkallës së dytë në mënyrë të veçantë, mund t'i nënshtrohet procedurës sipas revizionit me çka përmes vendimit gjyqësor të gjykatës së revizionit eliminohet vendimmarrja e ndryshme e gjykatës së shkallës së dytë për situata të njëjta”.*

77. Rrjedhimisht, Gjykata nga pretendimet vëren se parashtruesi i kërkesës i ndërlidh pretendimet për diskriminim me pamundësinë e realizimit të pretendimeve të tij. Për më tepër, vlen të theksohet që parashtruesi i kërkesës kishte sjellë para Gjykatës vendime të gjykatave të rregullta të shkallës së parë dhe të shkallës së dytë, ndërsa rasti i tij kishte marrë trajtimin në merita nga Gjykata Supreme, si gjykatë e shkallës më të lartë brenda juridiksionit të gjyqësorit të rregullt. Megjithatë, duke pasur parasysh përfundimet e Gjykatës lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë dhe vendim të arsyetuar nga pikat e mëparshme të këtij vendimi, sipas të cilave arsyetimet e vendimeve të kontestuara janë të qarta dhe logjike dhe se në këto arsytetime nuk ka elemente që tregojnë se vlerësimi i fakteve dhe provave në rastin konkret ishte keqpërdorur në dëm të parashtruesit të kërkesës dhe se zbatimi i së drejtës materiale dhe procedurale ka qenë arbitrar, dhe duke marrë parasysh se parashtruesi nuk ka ofruar prova përkatëse që do të tregonin për mundësinë që ai të jetë diskriminuar në ndonjë mënyrë tjetër përmes vendimeve të kontestuara, Gjykata konsideron se gjithashtu janë të pabazuara pretendimet e parashtruesit për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë.

78. Rrjedhimisht, pretendimet e lartcekura të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

## **Përfundim**

79. Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, si dhe pretendimet për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, janë pretendime që kualifikohen si pretendime “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësi

deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.


### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 5 nëntor 2024, njëzëri:

### **VENDOS**

- I. TË DEKLAROJË njëzëri kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

**Gjyqtari raportues**

  
Nexhmi Rexhepi



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

  
Gresa Caka-Nimani